



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 39

2000

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8668 datë 23.10.2000	Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit	1859
Vendim i KM nr.604, datë 17.11.2000	Për etikimin e produkteve ushqimore.....	1861
Vendim i KM nr.609, datë 17.11.2000	Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale, natyrale	1869
Vendim i KM nr.610, datë 17.11.2000	Për ndryshimin e listës së barnave, në vendimin nr.54, datë 2.2.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e barnave kryesore që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave”.....	1873
Vendim i KM nr.611, datë 17.11.2000	Për lejimin e përdorimit të procedurës “Prokurim i drejtpërdrejtë, për një paketë medikamentesh e materialesh mjekimi, me shoqërinë Fufarma, sh.a.....	1875

Vendim i KM nr.614, datë 17.11.2000	Për një shtesë në vendimin nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave,“Për lëshimin e Pasaportave Diplomatike dhe të Shërbimit”	1876
Vendim i KM nr.620, datë 23.11.2000	Për shitjen e pjesës së kapitalit shtetëror të sh.a, miniera e bitumit, Selenicë, Vlorë	1877
Vendim i KM nr.623, datë 23.11.2000	Për rritjen e pagës bazë të administratorëve dhe të specialistëve në shoqëritë huamarrëse dhe në Qendrën e Ankandeve, të caktuar me vendimin nr.209, datë 28.4.1999, të Këshillit të Ministrave.....	1877
Vendim i Gj.L nr.371	Për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76-25 të Kodit Penal dhe vrasjes me dashje në bashkëpunim mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 76-22-25 të Kodit Penal.....	1878

L I G J
Nr.8668, datë 23.10.2000

PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË
PËR JASHTË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Pasaporta për jashtë shtetit është dokumenti që vërteton identitetin dhe shtetësinë shqiptare të mbajtësit të saj, me anën e së cilës ai mund të dalë e të hyjë nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të udhëtojë nga një shtet i huaj në një tjetër.

Pasaporta për jashtë shtetit është një dokument me shkallë të lartë sigurie, në përputhje me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 2

Të gjithë shtetasit shqiptarë kanë të drejtë të pajisen me pasaportë.

Shtetasit shqiptarë, që me vendim të gjykatës kanë zotësi të pjesshme për të vepruar ose nuk kanë zotësi për të vepruar, pajisen me pasaportë vetëm me kërkesë të prindërve ose të kujdestarit të tyre.

Neni 3

Shtetasit deri në moshën 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 5 vjet, ndërsa ata mbi 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 10 vjet.

Në të gjitha rastet, vlefshmëria e pasaportës mund të zgjatet vetëm një herë, për një periudhë njëvjeçare.

Neni 4

Pasaporta shqiptare është e zakonshme, shërbimi dhe diplomatike.

Kriteret për lëshimin e pasaportës së shërbimit dhe asaj diplomatike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Pasaporta e zakonshme lëshohet nga Ministria e Rendit Publik, ndërsa pasaporta e shërbimit dhe ajo diplomatike lëshohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Për shtetasit shqiptarë, me banim jashtë shtetit, veprohet sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 6

Shtetasi pajiset me pasaportë të zakonshme pranë organit të policisë, në juridiksionin e vendbanimit të vet të përhershëm, pasi paraqet:

- kërkesën me shkrim;
 - çertifikatën e lindjes me fotografi;
 - fotografi të përmasave 4 x 5 cm (copë tre).
- Pajisja me pasaportë të zakonshme bëhet brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 7

Kërkesa dhe dokumentet për pajisjen me pasaportë, si dhe tërheqja e saj në organin e policisë bëhet nga vetë shtetasi ose nga i ngarkuari me prokurë të posaçme, ose nga prindi ose kujdestari për të miturit ose shtetasit pa zotësi për të vepruar.

Neni 8

- Shtetasit i bllokohet pasaporta kur:
- ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i saj e ka marrë atë duke falsifikuar dokumentet për lëshimin e saj;
 - në pasaportë ka shënime të bëra nga organe ose persona të paautorizuar;
 - ka lënë funksionin, për të cilin ka marrë pasaportën e shërbimit ose atë diplomatike.

Neni 9

- Pasaporta shpallet e pavlefshme kur:
- denoncohet nga vetë shtetasi se i ka humbur, i është vjedhur ose grabitur;
 - është dëmtuar nga pakujdesia e mbajtësit të saj;
 - i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;
 - vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10

Vlerësimi dhe administrimi i pasaportës së pavlefshme bëhet përkatësisht nga organi që e ka lëshuar.

Neni 11

Shtetasi ripajiset me pasaportë në rastet e përcaktuara në nenin 9, si dhe kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë. Për ripajisjen me pasaportë të zakonshme zbatohen të njëjtat rregulla si për marrjen e saj për herë të parë.

Neni 12

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me pasaportë të zakonshme përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Financave.

Neni 13

Modeli i pasaportës dhe sistemi i lëshimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Pajisja me pasaportë të re, sipas këtij ligji, do të bëhet pas përfundimit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese me të cilën është pajisur çdo shtetas shqiptar.

Neni 15

Dekreti nr.7393, datë 12.6.1990 “Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave”, me ndryshimet e bëra, si dhe çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2817, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.604, datë 17.11.2000

PËR ETIKIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17,18 dhe 41, të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995, “Për ushqimin”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullore “Për etiketimin e produkteve ushqimore”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Drejtoria e Cilësisë dhe Inspektimit të Ushqimeve, në Ministrinë e Bujqësisë, bën miratimin dhe kontrollin e etiketës dhe të formës së etiketimit të produkteve ushqimore, që prodhohen dhe tregtohen në vend, në përputhje me kërkesat e rregullore “Për etiketimin e produkteve ushqimore”.

3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

RREGULLORE MBI ETIKETIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE

1. Fusha e Përdorimit

Kjo rregullore përcakton mënyrën e etiketimit të të gjitha produkteve ushqimore të ambalazuara, që i ofrohen si të tilla konsumatorit për përdorim individual dhe kolektiv.

2. Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Deklarim” – do të kuptohet çdo prezantim që paraqet, sugjeron ose le të nënkuptohet që një produkt ushqimor ka cilësi të veçanta lidhur me origjinën e tij, vetitë ushqyese, natyrën e tij, përpunimin, përbërjen ose cilësi tjetër.

“Konsumator” – kuptohen personat dhe familjet që blejnë dhe marrin ushqime për të plotësuar nevojat personale.

“Ambalazh” – do të kuptohet çdo material paketues që shërben për paketimin e produkteve ushqimore, i cili mund të mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe vlerën ushqimore të tij, dhe e bën të përshtatshëm për

transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipe ambalazhesh në çastin që i ofrohet konsumatorit.

“Datë prodhimi” – do të kuptohet data në të cilën produkti është i gatshëm sipas përshkrimit.

“Datë ambalazhimi” – do të kuptohet data në të cilën produkti është vendosur në ambalazhin me të cilin do të shitet.

“Data e fundit e shitjes” – do të kuptohet data e fundit e ofrimit për shitje te konsumatori. Pas kësaj date ushqimi qëndron ende për një kohë të arësyeshme në ruajtje, në shtëpi.

“Data e qëndrueshmërisë minimale” ose “Më mirë të konsumohet para...” – do të kuptohet data e fundit e përdorimit të ushqimit në kushtet e dhëna të ruajtjes (në qoftë se janë vënë në etiketë), gjatë të cilës produkti ruan të gjitha vlerat cilësore dhe qëndron plotësisht i tregtueshëm. Produkti nganjëherë mund të jetë i vlefshëm dhe pas kësaj date.

“Data e fundit e përdorimit” (data e fundit e konsumimit e rekomanduar) – do të kuptohet data e mbarimit të afatit (skadimit), pas të cilit produkti nuk do të jetë me cilësinë që konsumatori ka të drejtë të pranojë. Pas kësaj date, produkti nuk duhet të konsiderohet si i tregtueshëm.

“Produkte ushqimore” ose “Ushqime” – do të kuptohen të gjitha lëndët e përpunuara, të përpunuara pjesërisht ose të papërpunuara, të destinuara për konsum njerëzor, në këtë term përfshihet pijet, çamçakizi dhe të gjitha lëndët që përdoren në prodhim, përgatitje ose përpunim të ushqimeve, me përjashtim të kozmetikës, duhanit ose të lëndëve që përdoren vetëm si medikamente.

“Shtesë ushqimore” (aditive) – do të kuptohet çdo lëndë, me ose pa vlera ushqyese që normalisht nuk është e konsumueshme si ushqim në vetvete dhe normalisht nuk përdoret si përbërës karakteristik i një ushqimi. Shtimi i saj në produktin ushqimor bëhet me qëllim teknologjik ose organo-shqisur, në procesin e prodhimit, të përpunimit, të përgatitjes, të trajtimit, të mbushjes, të ambalazhimit, të transportit ose të ruajtjes së këtij produkti. Merr pjesë në ushqimin ose nënproduktin e tij drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt duke u bërë komponent i tij dhe duke ndikuar në karakteristikat e ushqimit.

Në këtë grup nuk bëjnë pjesë ndotësit ose substancat e shtuara në produktin ushqimor për të mbajtur ose përmirësuar vetitë ushqyese.

“Ingredient” (përbërës) – do të kuptohet çdo substancë duke përfshirë dhe aditivet ushqimore të përdorur për prodhimin ose përgatitjen e një ushqimi dhe që ndodhet në produktin e gatshëm, megjithëse nganjëherë në formë të modifikuar (transformuar).

“Etiketë” – do të kuptohet çdo fishë, markë, pamje ose material tjetër i shkruar, i shkruar, stampuar, shabllonuar, gdhendur ose i vënë në ambalazh të një ushqimi ose i bashkëlidhur me të.

“Etiketim” – do të kuptohet çdo tekst i shkruar ose i stampuar ose çdo paraqitje grafike që figuron në etiketë, shoqëron produktin ose është vënë pranë tij për të nxitur shitjen.

“Parti mall” ose “Lotus” – do të kuptohet një sasi e një produkti ushqimor e prodhuar në kushte të njëjta.

“Paraambalazhim” – do të kuptohet vendosja paraprakisht e një produkti ushqimor në një ambalazh për t’ju ofruar konsumatorit ose për përdorim kolektiv.

“Ndihmës teknologjik” – do të kuptohet një lëndë ose një material, që nuk përdoret si ingredient ushqimor në përpunimin e lëndëve të para, të produkteve ushqimore ose të ingredientëve të tyre. Ai plotëson një funksion teknologjik të dhënë gjatë trajtimit ose përpunimit e që mund të shkaktojë praninë e padëshirueshme dhe të paevitueshme të mbetjeve ose derivateve të tyre në produktin e gatshëm. Në kuptimin e mësipërm përjashtohen të gjitha pajisjet ose mjetet e punës.

“Ushqim i destinuar për përdorim kolektiv” – do të kuptohen ushqimet e përdorura në restorante, mensa, shkolla, spitale dhe institucione të tjera të ngjashme ku ushqimi ofrohet për konsum të menjëhershëm.

3. Parime të Përgjithshme

3.1. Etiqueta e vënë mbi mallin e ambalazhuar nuk duhet të paraqesë mallin në mënyrë të gabuar, të rreme apo të krijojë një përshtypje të gabuar për natyrën e vërtetë të tij.

3.2. Ushqimet e ambalazuara nuk duhet të përshkruhen ose të paraqiten në etiketë me fjalë, pamje (figura) ose me çdo lloj mënyre tjetër që bën iluzion drejtpërdrejt ose tërthorazi për një produkt me të cilin ato mund të ngatërrohen ose me një mënyrë që i lehtë kuptojë blerësit ose

konsumatorit që ushqimi është i ngjashëm me atë produkt.

3.3. Etiketimi dhe metodat e përdorura nuk duhet të jenë të tilla që të paraqesin produktin ushqimor me veti ushqyese të veçanta, të cilat i atribuojnë atij veti për parandalimin dhe kurimin e sëmundjeve ose i referohen vetive të tjera kur produkti ushqimor realisht nuk i përmbante ato. Nga ky rregull përjashtohen ujrat mineralë natyralë.

4. Kërkesat e detyrueshme për etiketimin e produkteve ushqimore

Të dhënat e poshtëshënuara duhet të pasqyrohen në etiketën e çdo produkti ushqimor të ambalazhuar, me përjashtim të rasteve ku përdoret një rregullore e veçantë.

4.1. Emri i produktit

4.1.1. Emri duhet të tregojë natyrën e vërtetë të produktit, të jetë specifik dhe jo i përgjithshëm.

a) kur një standard ose rregullore teknike përcakton një ose disa emra për një ushqim duhet të përdoret të paktën njëri prej tyre.

b) Në raste të tjera duhet të përdoret emri i shkurtuar (i dhënë) në legjislacionin në fuqi.

c) Në qoftë se nuk ekziston një emër i tillë duhet të përdoret një emër i zakonshëm ose që përdoret shpesh ose një term përshkruues i përshtatshëm, që të mos kuptohet gabim nga konsumatori.

d) Asnjë emër tregtar, prodhimi ose i fantazuar nuk mund të përdoret pa qenë i shoqëruar me emërtimet sipas paragrafëve 4.1.1.1. deri 4.1.1.3. të kësaj rregulloreje.

4.1.2. Etiketa duhet të japë pranë emrit të produktit ose bashkëlidhur me të fjalën ose grupin e fjalëve të cilat ta informojnë drejt konsumatorin për natyrën dhe gjendjen e vërtetë të produktit, mënyrën e paraqitjes, llojin e përpunimit që i është bërë, si për shembull i dehidratuar, i koncentruar, i ristrukturuar, i tymosur etj.

4.2. Lista e ingredientëve (përbërësve)

4.2.1. Me përjashtim të ushqimeve të përbëra nga një ingredient (përbërës) i vetëm etiketa duhet të përmbajë një listë të plotë të tyre.

a) Lista e përbërësve duhet të jetë e bashkëlidhur ose të vijojë mbas termit “ingredientet” (përbërësit).

b) Të gjithë ingredientët duhet të renditen sipas rendit zvogëlues të peshës së tyre fillestare (m/m) në kohën e fabrikimit të produktit.

c) Kur një ingredient (përbërës) është vetë produkt i dy ose më shumë përbërësve ky i fundit do të deklarohet në listën e ingredientëve në vijim të listës, në kllapa ose thonjëza, sipas rendit zbritës në peshë.

Një ingredient (përbërës) i përbërë i cili përfshihet në legjislacionin në fuqi dhe përbën më pak se 25% të produktit nuk është e nevojshme të deklarohen ingredientët përbërës të tij nëse s’përdoret si aditiv (shtesë) ushqimor.

d) Uji i shtuar duhet të deklarohet në listën e ingredientëve me përjashtim kur bën pjesë vetë në ingredient i tillë si shëllirë, shurup, lëng mishi, që hyjnë në përbërjen e një ushqimi dhe deklarohet si i tillë në listën e ingredientëve. Uji ose përbërësit e tjerë flurore që avullojnë në procesin e përpunimit nuk është e nevojshme të deklarohen.

e) Ushqimet e koncentruara ose dehidratuara të cilat janë të destinuara për t’u riformuar nga tretja në ujë ingredientët do të renditen në bazë të përpjestimit në produktin e riformuar. Në këtë rast lista e ingredientëve plotësohet nga një shprehje e tillë “ingredientët e produktit të riformuar” ose “ingredientët e produktit të gatshëm”.

4.2.2. Për çdo ingredient që pasqyrohet në listën e ingredientëve do të përdoret një emër specifik sipas dispozitave të paragrafit 4.1. (Emri i produktit) të kësaj rregulloreje me përjashtim të rasteve që vijnë:

a) Emrat e kategorive të paraqitura në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje përdoren për ingredientët që i takojnë grupeve të dhëna.

b) Në çdo rast yndyra e dërrit, salloja dhe yndyra e gjedhit duhet të deklarohen me emrin e tyre specifik.

c) Për disa aditivë (shtesa) ushqimore brenda klasave funksionale (dhënë në Shtojcën 2 të kësaj rregulloreje), që lejohen të përdoren ushqime, me aktet ligjore apo nënligjore përkatëse, emri i klasës së poshtëshënuar vendoset përkrah emrit specifik ose numrit që i identifikon njohjen.

d) Për aditivët (shtesa) ushqimore që bëjnë pjesë në listën e krijuar (sipas Shtojcës 2 të kësaj rregulloreje) mund të përdoren dhe titujt e klasave funksionale të mëposhtme, si p.sh:

- aromë (aroma) dhe aromatizues
- amidon (amidone) i (të) modifikuar(a).

Termi “aromë” mund të specifikohet nga një term që e pason “natyrale”, “e njëjtë me substancën natyrale”, “artificiale” ose një kombinim i këtyre termave sipas rastit.

4.2.3. Ndhimesa teknologjike dhe mbartja e aditivëve ushqimorë

a) Çdo aditiv (shtesë) ushqimore mbartur në një ushqim në sasi të konsiderueshme ose të mjaftueshme për të kryer një funksion teknologjik, si pasojë e përdorimit në lëndët e para ose të ingredientëve të tjerë në të cilat është përdorur aditivi (shtesa), duhet të deklarohet në listën e ingredientëve.

b) Aditivët (shtesat) ushqimore të mbartur në ushqime në nivele nën ato të përcaktuara për të kryer funksion teknologjik nuk kanë nevojë të deklarohen në listën e ingredientëve.

4.3. Përmbajtja neto dhe pesha e thatë

a) Përmbajtja neto duhet të deklarohet sipas sistemit metrik (sistemi ndërkombëtar i njësive)

b) Përmbajtja neto duhet të deklarohet në mënyrën e mëposhtme:

- për ushqimet e lëngëta, në volum;
- për ushqimet e ngurta, në peshë;
- për ushqimet në gjendje gjysëm të ngurtë ose viskoze, në peshë ose volum.

c) Përveç deklarimit të përmbajtjes neto, produktet ushqimore të ambalazuara në mjedis të lëngët duhet të kenë një deklarim të shprehur në njësi matëse të masës së produktit pa lëngun. Me mjedis të lëngët kuptohet: uji, tretja ujore e sheqerit dhe e kripës, lëngjet e frutave e të perimeve vetëm në rastin e frutave e perimeve të konservuara si dhe uthulla, të vetme ose të kombinuara.¹

4.4. Emri dhe adresa

Emri dhe adresa e prodhuesit, e ambalazhuesit, e shpërndarësit, e importuesit, e eksportuesit ose e shitësit të mallit ushqimor duhet të jetë e deklaruar.

4.5. Vendi i origjinës së produktit duhet të jetë i deklaruar në çdo rast.

b) Në qoftë se një produkti ushqimor i bëhet përpunim në një vend të dytë, që i ndryshon natyrën, vendi ku bëhet ky përpunim, për qëllim etiketimi, duhet të konsiderohet si vendi i origjinës.

4.6. Identifikimi i partive të produkteve

Çdo ambalazh duhet të mbajë mbishkrim të gdhendur ose një markë të pashlyeshme me kod ose të qartë, që lejon të identifikohet fabrikën prodhuese dhe partinë mall.

4.7. Datimi dhe instruksionet e ruajtjes

4.7.1. Me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara në një standard apo rregull teknik individual, për datimin, përdoren kriteret e mëposhtme:

a) “Data e qëndrueshme minimale”.

b) Kjo datë duhet të përmbajë të paktën”

- ditën dhe muajin, për produkte me qëndrueshmëri minimale jo më shumë se 3 muaj;
- muajin dhe vitin, për produkte me qëndrueshmëri minimale mbi 3 muaj. Në qoftë se muaji është dhjetori përcaktimi i viti mjafton.

a) Data duhet të deklarohet me fjalët:

- “Është më mirë të përdoret para...” Në qoftë se është përcaktuar data.
- “Është më mirë të përdoret para fundit të...” për rastet e tjera.

a) Shënimi i kërkuar në pikën (c) duhet të jetë i plotësuar”

- ose nga vetë data; ose

- një referim ku është dhënë data.

a) Dita, muaji dhe viti duhet të tregohen qartë me rendin numerik të pakoduar.

b) Në kundërshtim me kriteret e pragmatit 4.7.1.(a) deklarimi i datës së qëndrueshmërisë minimale nuk kërkohet për:

- frutat dhe perimet e freskëta;

¹ . Deklarimi i përmbajtjes neto i përgjigjet sasisë së produktit në çastin e ambalazhimit, që i referohet sistemit të kontrollit sasior të bazuar mbi mesataren.

- verërat, verërat shkumëzuese, verërat e aromatizuara, verëra frutash dhe verëra shkumëzuese frutash;

- pijet që përmbajnë mbi 10% në vëllim alkool;

- prodhime brumërash dhe buke, që nga vetë natyra e tyre normalisht konsumohen brenda 24 orëve mbas prodhimit;

- uthulla;

- kripa e gjellës;

- sheqernat e ngurta;

- prodhime sheqeri të përbëra nga sheqer i ngjyrosur ose (dhe) i aromatizuar;

- çamçakiz.

4.7.2. Përveç datës së qëndrueshmërisë minimale në etiketë duhen vënë kushtet e veçanta për ruajtjen dhe magazinimin kur këto ndikojnë në afatin e ruajtjes.

4.8. Mënyra e përdorimit

Instruksionet për përdorim, duke përfshirë ristrukturimin e produktit (rikthim në gjendjen e zakonshme), kur është e nevojshme, duhet të deklarohet në etiketë për të siguruar përdorimin korrekt të produktit.

5. Kërkesa të detyrueshme shtesë

5.1. Etiketimi sipas sasisë së ingredientëve

a) Kur etiketimi në një ushqimi në mënyrë të veçantë vë theksin mbi një ose disa ingredientë të rëndësishëm dhe (ose) karakteristike të këtij ushqimi deklarohet në përqindje (m/m) sasia fillestare e ingredientëve në kohën e prodhimit.

b) Kur etiketimi i një produkti ushqimor vë theksin veçanërisht mbi përmbajtjen e ulët të një ose të disa ingredientëve duhet të deklarohet përqindja (m/m) e këtij ingredientit në produktin përfundimtar.

c) Referimi në emrin e një ushqimi për një ingredient të caktuar nuk duhet të përbëjë në vetvete vendosjen e një theksi të veçantë. Në etiketimin e një ushqimi përdorimi i një ingredientit në sasi të vogël dhe vetëm si aromatizues nuk duhet të përbëjë në vetvete vendosjen e një theksi të veçantë.

5.2. Ushqimet e rrezatuara

a) Etiketa e çdo ushqimi që është i trajtuar me rrezatim jonizues duhet të ketë shkruajtur shënimin që e tregon këtë, menjëherë pas emrit të ushqimit. Gjithashtu përdoret dhe simboli ndërkombëtar i ushqimeve të rrezatuara, i cili duhet të pasqyrohet pranë emrit të ushqimit.

b) Kur një produkt i rrezatuar është përdorur si ingredient në një ushqim tjetër, duhet të paraqitet si i tillë në listën e ingredientëve.

c) Në qoftë se një produkt përbëhet vetëm nga një ingredient dhe përgatitet duke u nisur nga një lëndë e parë që ka patur trajtim me rrezatim, etiketa e produktit duhet të ketë shënimin që tregon trajtimin e përdorur.

6. Përjashtime nga kërkesat e detyrueshme të etiketimit

Erëzat dhe bimët në njësi të vogla të ambalazheve, ku sipërfaqja më e madhe e të cilave është më e vogël se 10 cm², mund të përjashtohen nga kërkesat e përcaktuara në paragrafët: 4.2; 4.6; 4.7 dhe 4.8 të kësaj rregulloreje.

7. Shënimet e padetyrueshme të etiketimit

Çdo tekst i shkruajtur ose i stampuar (i dhënë), ose çdo praqitje grafike (pamje) mund të pasqyrohet mbi etiketë me kusht që të mos jetë në kundërshtim me dispozitat e detyrueshme për të cilat flitet në paragrafin 3 “Parime të përgjithshme” të kësaj rregulloreje.

7.2. Përcaktimet e cilësisë

Në qoftë se përdoren treguesit e cilësisë ato duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe asnjëherë të mos keqkuptohen apo të jenë të rreme.

8. Paraqitja e informacionit të detyrueshëm

8.1. Të përgjithshme

Etiketa e produkteve ushqimore të ambalazuara duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet (shqitet) nga ambalazhi.

b) Shënimet e detyrueshme të kësaj rregulloreje apo të çdo standardi individual duhet të jenë

të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme nga konsumatori në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

c) Në qoftë se ambalazhi është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar (zënë) nga ambalazhi.

d) Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

8.2. Gjuha

a) Në qoftë se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër (nëse kërkohet) në vend të rietiketimit.

b) Në rastin kur etiketa është zëvendësuar apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.

SHTOJCA 1

GRUPI I INGREDIENTËVE	EMRI I KATEGORISË
Vajra të rafinuar me përjashtim të vajit të ullirit	“Vaj” i cilësuar “vegjetal” (bimore) ose “shtazor” dhe i “hidrogjenuar” ose “pjesërisht i hidrogjenuar” sipas rastit.
Lëndë yndyrore e rafinuar	- “Lëndë yndyrore” e cilësuar “vegjetale” (bimore) ose “shtazore” sipas rastit.
Përzjerje miellrash që përmbajnë dy ose më shumë lloje drithërash.	“Miell”, ndjekur nga një listë e drithrave, të cilat vendosen në rend zbritës në peshë.
Amidone, përveç amidoneve të modifikuar kimikisht.	“Amidone”.
Të gjitha llojet e peshkut, ku peshku përmban një ingredient të një produkti tjetër ushqimor dhe me kusht që emri dhe paraqitja e një produkti të tillë ushqimor të mos referohet si një lloj specifik peshku	“Peshk”.
Të gjitha llojet e mishit të shpendëve, ku një mish i tillë përmban një ingredient të një produkti tjetër ushqimor dhe me kusht që emri dhe paraqitja e një produkti të tillë të mos referohet si një tip specifik i mishit të shpendit.	“Mish shpendi”.
Të gjithë tipet e djathrave ku djathi ose përzjerjet e djathrave përmbajnë një ingredient të një produkti ushqimor dhe me kusht që emri dhe paraqitja e një produkti të tillë ushqimor të mos referohet si një tip specifik i djathrave.	“Djath”.
Të gjitha erëzat dhe ekstatet e tyre që nuk kalojnë më shumë se 2% në peshë në produktin ushqimor, i vetëm ose i kombinuar.	“Erëz”, “Erëza” ose “përzjerje erëzash” sipas rastit.
Çdo bimë ose përzjerje bimësh, kur nuk kalon 2% në peshë në produktin ushqimor, i vetëm ose i kombinuar.	“Barëra” ose “përzjerje barërash” sipas rastit.
Të gjithë tipet e gomave të përdorura për fabrikimin e gomës të destinuar për çamçakizët.	“Gomë baze”.
Të gjithë llojet e sheqernave.	“Sheqer”.
Dekstroze anhidre dhe dekstrozë monohidrate.	“Dekstrozë ose glukozë”.
Të gjithë tipet e kazeinateve.	“Kazienate”.
Gjalpë kakao me presim, me shtrydhje ose rafinim.	“Gjalpë kakao”
Të gjitha frutat e përpunuara me sheqer, kur nuk kalojnë 10% të peshës së produktit ushqimor	“Fruta të përpunuara”

SHTOJCA 2

Acidet
Agjentët e mbajtjes (ruajtjes) së ngjyrës
Agjentët shtresues
Agjentët kundër formimit të shkumave
Agjentët voluminoz
Agjentët xhel-formues
Agjentë lagështimi
Agjentë përshtatës
Agjentë ardhjeje (fermentimi) stabilizues
Agjentë formues
Antioksidantët
Anti aglomerante (antingjitës)
Ëmbëlsuesit
Emulsifikatorët
Forcues arome
Konservantët
Kripërat që formojnë emulsione
Mpikësit (trashësit)
Ngjyruarit
Përmirësuesit e miellit
Rregullatorët e acidit
Stabilizuesit i ëmbëlsuesit
Zmadhuesit e fuqisë së aromave

V E N D I M

Nr.609, datë 17.11.2000

PËR INDUSTRIALIZIMIN DHE TREGTIMIN E UJËRAVE MINERALE, NATYRALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit 7941, datë 31.5.1995, “Për ushqimin”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e kushteve që plotësojnë ujërat minerale, natyrale të ambalazuara (industrializuara), të çdo lloji, të prodhuara në vend ose të importuara, që përdoren për konsum njerëzor.

Ky vendim nuk zbatohet.

- për ujërat që janë produkte mjekësore
- për ujërat minerale, natyrale, të stabilimenteve termale dhe hidrotermale
- për ujërat minerale, që përdoren për qëlime të tjera.

2. Uji mineral natyral nënkupton ujë të pastër dhe të shëndetshëm nga pikëpamja mikrobiologjike dhe fiziko-kimike (shtojca 1 e këtij vendimi), me origjinë nga një burim ose shtresë nëntokësore dhe që nxirret nga toka nëpërmjet një ose më shumë daljeve natyrore ose puseve të shpuara.

3. Uji mineral natyral dallohet, dukshëm, nga uji i pijshëm, i zakonshëm;

3.1. nga natyra e tij, e cila karakterizohet nga përmbajtja e elementëve minerale, oligomineraleve dhe e përbërësve të tjerë;

3.2. nga origjina e tij, uji vjen drejtpërdrejtë nga shtresat ujore, nëntokësore, përmes

burimeve natyrale ose shpimeve;

3.3. nga qëndrueshmëria në përbërje, debit, temperaturë dhe karakteristika të tjera thelbësore (gjithnjë duke marrë parasysh ciklet e luhatjeve natyrore);

3.4. nga trajtimet, uji mineral natyral nuk duhet të jetë subjekt i ndonjë trajtimi ose plotësimi tjetër, përveç;

- ndarjes së elementëve të paqëndrueshëm, siç janë komponimet e hekurit dhe të squfurit, me anë të filtrimit ose të dekantimit, që në fakt paraprihet me ajrim, për sa kohë ky përpunim nuk ndryshon përbërjen e ujit në përbërësit thelbësorë që i japin atij vetitë karakteristike;

- largimin e pjesshëm ose të plotë të gazit karbonik të lirë me metoda fizike;

- shtimit ose rishtimit të gazit karbonik, sipas shojcës 2 të këtij vendimi.

4. Uji mineral, natyral, merret në kushte që sigurojnë pastërtinë mikrobiologjike. Ndalohet çdo trajtim për dezinfektim në çfarëdo kuptimi, për shtimin e lëndëve bakteristatike ose ndonjë trajtim i ngjashëm, që ndryshon karakteristikat natyrale të ujit.

Këto dy karakteristika të ruhen të paprekura dhe të mbrohen nga rreziku i ndotjes për shkak të origjinës nëntokësore të ujit.

5. Ujërat minerale, natyrale, në varësi të përmbajtjes së kripërave minerale klasifikohen në 4 kategori, sipas shtojcës 3 të këtij vendimi.

6. Ujërat minerale, në varësi të përmbajtjes së gazit karbonik dhe të origjinës së tij klasifikohen në tri kategori, sipas shtojcës 2 të këtij vendimi.

7. Karakteristikat e mësipërme, që i japin ujit mineral, natyral, veti të dobishme për shëndetin, vlerësohen sipas kritereve, që përcaktohen në shtojcën 1 të këtij vendimi, me anë të metodave shkencore, të njohura, nga këndvështrimi:

- gjeologjik dhe hidrogeologjik;

- fizik, kimik dhe fiziko-kimik;

- mikrobiologjik;

dhe, nëse është e nevojshme farmakologjik dhe klinik (si rregull, kur uji përmban jo më pak se 1000 mg/lëndë të thata ose jo më pak se 250 mg/l gaz karbonik të lirë).

8. Shfrytëzimi i burimeve të ujërave minerale, realizohet si më poshtë:

a) Industrializimi i një burimi të ujit mineral, natyral, lejohet vetëm pas licensimit nga organet përgjegjëse, të ngarkuara me ligj dhe aktet nënligjore në fuqi dhe ku paraprakisht është vërtetuar se uji plotëson kërkesat e pikave 2,3 dhe 4 të këtij vendimi.

b) Për shkak të ndryshimit të shpeshtë të vetive të ujërave, licensa duhet të ripërtërihet çdo 2 vjet.

c) Pajisjet për industrializimin e ujit të jenë të vendosura në mënyrë të tillë që të shmanget çdo mundësi kontaminimi dhe të ruhen vetitë që uji zotëron që në burim dhe konkretisht:

- burimi ose dalja e ujit të mbrohen nga rreziku i ndotjes;

- depozitat, tubacionet dhe rezervuarët të ndërtohen prej materialesh të tilla, që të parandalojnë çdo ndryshim kimik, fiziko-kimik ose mikrobiologjik të tij;

- pajisjet teknologjike, sidomos pajisjet e larjes dhe të ambalazhimit, të plotësojnë normat higjienike, sidomos pajisjet e larjes dhe të ambalazhimit, të plotësojnë normat higjienike. Rezervuarët e ujit mineral, natyral, të jenë të tillë që të mos ndryshojnë karakteristikat fiziko-kimike të tij dhe të mos lejojnë ndotjen mikrobiologjike;

- ndalohet transporti i ujit mineral për te konsumatori i fundit ose nga burimi te impianti i ambalazhimit në tanke të tjerë përveç atyre të autorizuar nga organi përgjegjës;

- kur gjatë industrializimit zbulohet se uji është ndotur dhe nuk ka më karakteristikat mikrobiologjike sipas shtojcës 1 të këtij vendimi, stabilimenti është i detyruar të pezullojë të gjitha veprimet derisa shkaku i ndotjes të shmanget plotësisht dhe uji të plotësojë kushtet sipas shtojcës 1 të këtij vendimi.

9. Ambalazhimi dhe etiketimi.

9.1. Çdo njësi ambalazhi, e përdorur për ambalazhimin e ujit mineral, natyral, të projektohet me mbyllje të përshtatshme, për të shmangur çdo mundësi falsifikimi ose kontaminimi.

9.2. Mbi ambalazh të shënohet “ujë mineral, natyral”. Në rast të ujit me gaz të shënohet “ujë mineral, natyral, me gaz nga burimi” ose “ujë mineral, natyral, me gaz karbonik të shtuar”.

Në rast se uji i është nënshtruar ndonjë përpunimi të përmendur në pikën 8, shkronja “b”, shtohet shënimi “plotësisht i degëzuar” ose “pjesërisht i degëzuar”.

9.3. Etiketat, gjithashtu duhet të përmbajnë, detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

- përbërësit analitikë, me karakteristikat e përcaktuara nga një institucion zyrtar, i njohur nga ligji, shoqëruar me datën e analizës;
- emrin e burimit dhe vendndodhjen e tij.

Ndalohet tregtimi i ujit mineral, natyral, i të njëjtit burim me më shumë se një emërtim tregtar.

9.4. Kur etiketat ose mbishkrimet kanë një përshkrim tregtar tjetër nga emri i burimit ose i vendit të shfrytëzimit, atëherë këta të fundit shënohen, me shkronja kapitale, së paku me madhësi sa gjysma e përmasave të shkronjave të përdorura për përshkrimin tregtar.

9.5. Ndalohet përdorimi i shenjave të veçanta, i emrave të pronësisë, i markave tregtare, i markave të fabrikës, i ilustrimeve ose i shenjave të tjera emblematike ose jo në etiketa dhe reklama në rastet kur:

- sugjerohet një karakteristikë që uji nuk e ka, veçanërisht përsa i përket origjinës, datës së autorizuar për shfrytëzimin e tij, rezultateve të analizave ose të dhëna të tjera që lidhen me autenticitetin.

- në ujërat e pijshëm, të ambalazhuar, që nuk janë në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

9.6. Ndalohet shënimi në etiketë i treguesve, që u atribuohen vetive kuruese të ujërave minerale, në qoftë se vetitë e mësipërme nuk janë vërtetuar nga organet përgjegjëse me anë të metodave shkencore të njohura, ku përfshihen analizat farmakologjike, fiziologjike dhe ekzaminimet klinike.

9.7. Për mosrespektimin e kërkesave që parashikohen në pikat 9.5 dhe 9.6 të këtij vendimi, merren masa ndëshkimore, sipas neneve 37 dhe 38, të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995, “Për ushqimin”.

10. Uji mineral, natyral përveç karakteristikave të veçanta, duhet të plotësojë edhe normat e përgjithshme, që janë përcaktuar në STASH 3904-1998 dhe në vendimin nr.145, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e “Rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.

11. Marrja e mostrave dhe analizat fiziko-kimike e mikrobiologjike të bëhen sipas metodave të njohura dhe të pranura në rang ndërkombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

SHTOJCA 1

KRITERE DHE KËRKESA PËR APLIKIM (LIÇENSIM)

KËRKESA GJEOLGJIKE DHE HIDROGJEOLGJIKE

- 1.1. Vendosi ekzakte e ujëmbledhësit, duke shënuar lartësinë e tij në një hartë me një shkallë jo më të vogël se 1:1000;
- 1.2. Një raport i detajuar gjeologjik mbi origjinën dhe natyrën e terrenit;
- 1.3. Shtrirja hidrogeologjike e shtresave;
- 1.4. Një përshkrim i operacioneve ujëmbledhëse;
- 1.5. Ndarja e zonave ose detaje të tjera, mbi marrjen e masave për mbrojtjen e burimit nga ndotja.

KËRKESË FIZIKE, KIMIKE E FIZIKO-KIMIKE

- 2.1. Shkalla e qarkullimit të burimit;
- 2.2. Temperatura e ujit të burimit dhe temperatura e ambientit;
- 2.3. Marrëdhëniet ndërmjet natyrës së terrenit dhe natyrës dhe tipit të mineraleve në ujë;
- 2.4. Mbetja e thatë në temperaturën 180o C dhe 2600 C;
- 2.5. Përcjellshmëria elektrike ose rezistenca, matur në temperatura të specifikuar;
- 2.6. Përqëndrimi i joneve hidrogjen (pH);
- 2.7. Anionet dhe kationet;
- 2.8. Elementet jo-jonizues;
- 2.9. Elementet gjurme;
- 2.10. Vetitë radio-aktive të burimit;
- 2.11. Nivelet relative të izotopeve të elementeve përbërës të ujit, oksigjenit (16 O-18 O) dhe hidrogjenit (protium, deuterium, tritium);
- 2.12. Toksiciteti i disa elementeve përbërës të ujit, duke marrë parasysh normat e vendosura për secilin prej tyre.

KËRKESA MIKROBIOLOGJIKE

- 3.1. Analizat mikrobiologjike të demonstrojnë:
 - mungesën e plotë të parazitëve si dhe mikroorganizmave patogjene
 - mungesën e escherichia coli dhe coliformeve të tjerë në 250 ml. Në 37o C dhe 44.50C.
 - mungesën e streptokokeve fekale në 250 ml.
 - mungesën e anaerobeve sporogjene sulfito-reduktues në 50 ml.
 - mungesën e pseudomonas aeruginosa në 250 ml. Ujë të ekzaminuar;
- 3.2. Norma për numrin total të mikroorganizmave nuk duhet të kalojë:
Në ujin e ambalazhuar
 - 100 për ml. në 20-220 për 72 orë në agar- agar ose agar- xhelatinë
 - 20 për ml. në 370 C për 24 orë në agar- agarNë burim:
 - 20 për ml. në 20-220 C për 72 orë në agar-agar ose agar-xhelatinë
 - 5 për ml. në 370 për 24 orë në agar- agar.Analiza mikrobiologjike e ujit mineral natyral në burim dhe të ambalazhuar bëhet jo më vonë se 12 orë dhe me kushte të ruajtjes së kampionit në temperaturë jo më të lartë se 40 C.

KËRKESA KLINIKE E FARMAKOLOGJIKE

- 4.1. Analizat, të cilat kryhen në përputhje me metoda shkencore të njohura, të vërtetojnë karakteristika të veçanta të ujit natyral mineral dhe efektet e tij në organizmin e njeriut, të tilla si diuretia, funksionet gastrite dhe intestinale, kompensimin e deficiencave në elemente minerale etj.

SHTOJCA 2

KLASIFIKIMI SUPLEMENTAR NË LIDHJE ME BULËZIMIN E UJRAVE MINERALE NATYRALE

Në burim ose mbas ambalazhimit, bulëzimi i Ujrave minerale natyrale, në kushte normale temperature dhe presioni, jep spontanisht dhe në mënyrë të qartë vizive përmbajtjen e gazit karbonik. Në varësi të bulëzimit dhe origjinës së gazit karbonik, ujrat klasifikohen në tre kategori të cilat përshkruhen respektivisht si më poshtë:

1. “ujë mineral natyral natyralisht i karbonuar (gazuar)” nënkupton ujin, i cili përmban

dioksid karboni edhe pas dekantimit dhe e ruan atë dhe pas ambalazhimit, duke pasur parasysh rifutjen (në qoftë se është e nevojshme) të një sasive dioksidi karboni ekuivalente me atë të përfutur nga i njëjti burim uji ose depozite (pusi) dhe që është çliruar gjatë operacioneve të mësipërme dhe që është subjekt i tolerancave teknike të zakonshme.

2. “ujë mineral natyral, përforcuar me gaz nga burimi” nënkupton ujin, i cili pas dekantimit dhe ambalazhimit ka një përmbajtje gazi më të madhe se në burim ose depozitë (pus). Gazi i futur ka origjinë nga burimi.

3. “ujë mineral natyral i karbonuar (gazuar) nënkupton ujin, të cilit i është shtuar dioksid karboni me origjinë tjetër nga burimi ose pusi, nga i cili rrjedh.

SHTOJCA 3 KLASIFIKIMI I UJRAVE MINERALE NATYRALE

Ujrat minerale natyrale në vartësi të përmbajtjes së kripërave minerale klasifikohen si më poshtë:

Ujë mineral natyral me përmbajtje shumë të ulët të kripërave minerale, jo më shumë se 50 mg/l.

Ujë mineral natyral me përmbajtje të ulët të kripërave minerale, jo më shumë se 500 mg/l.

Ujë mineral natyral me përmbajtje mesatare të kripërave minerale, 501 mg-1500 mg/l.

Ujë mineral natyral me përmbajtje të lartë të kripërave minerale, më shumë se 1500 mg/l:

Bikarbonate, më shumë se 600 mg/l

Sulfate, më shumë se 200 mg/l

Klorure, më shumë se 200 mg/l

Kalcium, më shumë se 150 mg/l

Magnez, më shumë se 50 mg/l

Fluor, më shumë se 1 mg/l

Hekur bivalent, më shumë se 1 mg/l

Natrium, më shumë se 200 mg/l (për personat me dietë, përmbajtje e ulët natriumi më pak se 20 mg/l).

Gazi karbinik i lirë, më shumë se 250 mg/l.

V E N D I M Nr.610, datë 17.11.2000

PËR NDRYSHIMIN E LISTËS SË BARNAVE, NË VENDIMIN NR.54. DATË 2.2.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E BARNAVE KRYESORE QË RIMBURSOHEN DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 4, të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të listës së barnave kryesore, që rimburohen nga sigurimet shëndetësore, të miratuar me vendimin nr.54, datë 2.2.1996, të Këshillit të Ministrave, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për

zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtre.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA NR.1
NDRYSHIMET NË LISTËN E BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA SIGURIMET
SHËNDETËSORE

Në listën e barnave që rimbursohen nga Sigurimet Shoqërore
Hiqen barnat:

Emërtimi dhe fuqia e barit

Forma

1. Acidum ascorbicum 100 mg	Tabl.
2. Acidum boricum (Pluhur për përgatitje 1g-3g)	Kg.
3. Aluminium Hydroxydum 150 ml Pezulli	Fl.
4. Amobarbitalum (Pluhur për përgatitje)	Gr.
5. Benzylis benzoas 25 % 11	Fl.
6. Chloroquinum 250 mg	Tabl.
7. Cortisoni acetat (Pluhur për përgatitje)	Gr.
8. Dapsonum 100 mg	Tabl.
9. Ephedrini hydrochloridum (Pluhur për përgatitje)	Gr.
10. Ergotaminum 2 mg	Tabl.
11. Methioninum 500 mg	Tabl.
12. Methylosanilinii chloridum (Pluhur për përgatitje)	Kg.
13. Methylthioninii chloridum (Pluhur për përgatitje)	Kg.
14. Natrii citras (Pluhur për përgatitje)	Kg.
15. Nystatinum 500.000 Nj.N (Pluhur për përgatitje)	Kg.
16. Papaverini hydrochloridum (Pluhur për përgatitje)	Kg.
17. Phenoxymethylpenicillinum 250 mg/5 ml-60 ml (pezulli)	Fl.
18. Pulvis natrii chloridi cum glucoso compositus 27.9 g	Pako.
19. Resorcinolum (pluhur për përgatitje)	Kg.
20. Sirupus multivitaminii (A,D2,B1,B2,B6,C,E...) 100 ml	Fl.
21. Sirupus Pertussini 100 ml	Fl.
22. Thiaminum 10 mg	Tabl.
23. Triamterenum 100 mg	Kaps.

Shtohen barnat:

Emërtimi dhe fuqia e barit

Forma

1. Letrozol 2.5 mg	Tabl.
2. Danazol 200 mg	Tabl.
3. Tamsulosin 0.4 mg	Kaps.
4. Finasterid 5 mg	Tabl.
5. Dihydratohisterol 0.1%-15 ml	Fl.
6. Risperidon 4 mg	Tabl.
7. Coclosporin 25 mg	Kaps.
8. Ciclosporin 50 mg	Kaps.
9. Ciclosporin 100 mg	Kaps.

V E N D I M
Nr.611, datë 17.11.2000

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË,
PËR NJË PAKETË MEDIKAMENTESH E MATERIALESH MJEKIMI, ME SHOQËRINË
FUFARMA, SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.7971, dtë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor publik, që janë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, për të përdorur procedurën “prokurim i drejtpëdrejtë“ me shoqërinë Fufarma, sh.a, për një paketë medikamentesh dhe materialesh mjekimi, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të ndjekë procedurat e negociimit me shoqërinë Fufarma, sh.a.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA 1

1.Antibiotikë:

- a. Ampicilinë x 1 gr
- b) Amikacinë x 0.5 dhe 1 gr.
- c) Cefazolinë x 1 gr. Dhe 0.5 gr.
- d) Gentamicinë x 40 dhe 80 mgr.

2. Infuzione dhe solucione injektabel:

- a) Solucion glukoze 5%, 10% dhe 40%
- b) Solucion Nacl (Fiziologjik) 0.9% dhe 10%
- c) Solucion Ringer dhe Manitol
- d) Solucione të tjerë injektabel si Analginë, Ca Bromur, Ca Glukonat, Na Bikarbonat, Prozerinë, Adrenalinë, Furosemide dhe Oxitocinë.

3. Narkotikë dhe Psikotrope:

- a) Petidinë, Morphinë dhe Diazepam
- b) Fentanyl, Tiopental
- c) Halothame, Myorelaxinë
- d) Metadone

4. Materiale Mjekimi dhe Ndihmëse:

- a) Sisteme infuzioni dhe shiringa e dorëza kirurgjikale njëpërdorimshe
- b) Antidifterik, antirabies, antivipera, antitetanik

5. Lëndë të para famaceutike

- a) Glukozë
- b) NaCL
- c) Laktozë
- d) Talk
- e) Alkool
- f. Manitol

V E N D I M
Nr.614, datë 17.11.2000

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 3 të vendimit nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, shtohen:
“- Sekretari i përgjithshëm, në ministri, në Gjykatën Kushtetuese, në Avokatin e Popullit, në Kontrollin e lartë të Shtetit dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Kancelari i Gjykatës së Lartë.”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

V E N D I M
Nr.620, datë 23.11.2000

PËR SHITJEN E Pjesës së Kapitalit Shtetëror të SH.A, MINIERA E BITUMIT,
SELENICË, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998, “Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pjesa 30 për qind e aksioneve në pronësi të shtetit shqiptar, e përfaqësuar nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në sh.a, Miniera e Bitumit, Selenicë, Vlorë, së bashku me pjesën tjetër prej 70 përqindësh të aksioneve, në pronësi të shoqërisë “Vefa Holding”, sh.p.k, në administrim, të shitet nga administratorët e shoqërive huamarrëse, pranë Qendrës së Ankandëve të Shitjes Publike me Tender, për shkak të likuidimit të kësaj shoqërie.

Shitja e aksioneve të realizohet sipas dispozitave në fuqi për shitjen e pasurive të skemave piramidale.

2. Të ardhurat e realizuara nga shitja për pjesën 30 për qind, të aksioneve të zotëruara nga shteti në sh.a, Miniera e bitumit, Selenicë, Vlorë, të derdhem në buxhetin e shtetit, pasi të jenë zbritur detyrimet e prapambetura dhe të papaguara nga shoqëria për sigurimet shoqërore dhe për energjinë elektrike, respektivisht në raport 70 me 30 për qind, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi sipas kërkesave të këtyre institucioneve.

3. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ta pajisë blerësin e ri me lejen e shfrytëzimit të vendburimit në zonën 1.7 km², në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7796, datë 17.12.1994, “Minerar i Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.623, datë 23.11.2000

PËR RRRITJEN E PAGËS BAZË TË ADMINISTRATORËVE DHE TË SPECIALISTËVE NË SHOQËRITË HUAMARRËSE DHE NË QENDRËN E ANKANDEVE, TË CAKTUAR ME VENDIMIN NR.209, DATË 28.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8227, dastë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.209, datë 28.4.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Paga bazë e administratorëve dhe e specialistëve në shoqëritë humarrëse dhe në Qendrën e Ankandeve, duke filluar nga data 1 tetor 2000, rritet mesatarisht 10 për qind. Niveli i pagës mujore, të administratorëve dhe të specialistëve të Qendrës së Ankandeve, zëvendësohet me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për mbulimin e rritjes së pagës bazë të përballohen nga fondi i pagave i planifikuar për Këshillin Kombëtar të Mbikëqyrjes për vitin 2000.

3. Në fund të pikës 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për shpejtimin e procesit të transparencës, Grupi i Mbikëqyrjes ka të drejtë të lëvizë administratorë nga njëra shoqëri humarrëse në tjetrën, pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të tyre”.

4. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Financave, Departamenti i Administratës Publike dhe grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

NIVELI I PAGAVE BAZË MUJORE TË ADMINISTRATORËVE DHE EKSPERTËVE TË
QENDRËS SË ANKANDEVE

	Paga bazë mujore (në lekë)
1. Administratore	49 500
2. Administratore për arkëtimin e detyrimeve dhe vlerave financiare të pronësisë nga transaksionet e pronësisë	38 500-49 500
3. Specialiste pranë Qendrës së Ankandeve	33 000-44 000

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Bashkim Caka	Anëtar
Agron Lamaj	“
Vitore Tusha	“
Nikoleta Kita	“
Valentina Kondili	“
Natasha Sheshi	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Tefta Caka	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Ylvi Myrtja	“
Perikli Zaharia	“
Artan Hoxha	“

Në seancën gjyqësore të datës 15.09.2000 dhe 27.10.2000 mori në shqyrtim çështjen civile nr.156 që i përket:

TË PANDEHURVE:BAKI HUQI, në mungesë
ALBERT HUQI, në mungesë; të dy të përfaqësuar nga avokatët Shefqet Muçi, Idajet Hoxha e Selfo Dosti.

AKUZA: Për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76-25 të Kodit Penal dhe vrasjes me dashje në bashkëpunim mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 76-22-25 të Kodit Penal.

Dy të pandehurit Baki Huqi dhe Albert Huqi, janë dërguar për gjykim me akuzat:
Baki Huqi sipas neneve 76-25 të Kodit Penal, 76-25-22 të Kodit Penal, 238 të Kodit Penal dhe 278/2 të Kodit Penal.

Albert Huqi sipas neneve 76-25 të Kodit Penal dhe 76-25-22 të Kodit Penal.

Është pretenduar se ngjarja ka ndodhur në këto rrethana:

Më datën 10 shkurt 1997 i pandehuri Albert Huqi me shokun e tij Arben Pumi, kanë hyrë në një sallë lojrash bingo në qytetin e Durrësit.

Kanë qëndruar për pak kohë dhe për disa minuta Arben Pumi, është larguar nga vendi ku

ishte ulur, për të blerë biletë. Kur është kthyer në karrigen e tij ishin ulur persona të tjerë dhe për këtë shkak ka hyrë në grindje e mosmarrëveshje me vëllezërit Xhixhabesi. Në këtë grindje ka hyrë edhe i pandehuri Albert Huqi, sa është dashur ndërhyrja e punonjësve të sallës së bingos që të qetësohet situata.

Në pasditen e po kësaj date Albert Huqi dhe Baki Huqi kanë shkuar përsëri në sallën e bingos për të vazhduar lojën. Atje kanë gjeur edhe vëllezërit Xhixhabesi. I pandehuri Albert është acaruar përsëri me të dëmtuarin Përparim Xhixhabesi dhe ka tentuar ta qëllojë atë me levë, veprime të cilat janë parandaluar nga ndërhyrja e personave të pranishëm.

Në këtë moment ndërhyrja e pandehurit Baki Huqi dhe qëllon me automatik në drejtim të vëllezërve Xhixhabesi duke i shkakuar vdekjen vdekjen Ardian Xhixhabesit dhe plagosje të rëndë Përparim Xhixhabesit.

Gjykata e rrethit Durrës me vendimin nr.205, dtë 30.10.1998 ka deklaruar fajtor dhe dënuar të pandehurin Baki Huqi me 20 vjet burgim, sipas neneve 76-25 të Kodit Penal, 76-25-22 të Kodit Penal dhe 55 të Kodit Penal.

Ka vendosur: Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Baki Huqi për veprat penale të parashikuara nga nenet 238, 278/2 të Kodit Penal, në zbatim të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit 8202, datë 27.3.1997, për shkak se janë amnistuar.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Albert Huqi dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim, sipas neneve 76-25 të Kodit Penal, 76-2-22 të Kodit Penal dhe 55 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.48, datë 10.3.1999 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.205, datë 30.10.1998 të gjykatës së rrethit Durrës dhe kthimin e akteve po kësaj gjykate për të pandehurin Baki Huqi, për t'u rigjykuar nga një tjetër trup gjykues.

Prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes përsa i përket të pandehurit Albert Huqi, pasi nuk vërtetohet fajësia e këtij të pandehuri.

Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs prokurori pranë gjykatës së Apelit Durrës dhe kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit vetëm në pjesën që bëhet fjalë për të pandehurin Albert Huqi dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë gjykatës së rrethit Durrës duke parashtuar këto shkaqe:

I pandehuri Albert Huqi ka qenë shkaktar i grindjes të ndodhur pasditen e datës 10.2.1997 meqenëse e ndjente veten të fyer nga grindja e ndodhur mëngjesin e po kësaj dite. Për këtë shkak ka tentuar të godasë me levë të dëmtuarin Përparim Xhixhabesi. Hetimi paraprak dhe gjykimi kanë vërtetuar këto fakte dhe bashkëpunimin në vrasje.

Gjykata e Apelit Durrës është kontradiktore në vendim, sepse deklaroi të pafajshëm të pandehurin Albert Huqi për vrasje, në një kohë që për të pandehurin Baki Huqi e kthen çështjen për rishqyrtim për t'u gjykuar me akuzat e dërguara nga prokuroria, duke pranuar edhe bashkëpunimin në vrasje.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin datë 16.6.1999 ka vendosur:

Kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara me qëllim ndryshimi dhe unifikimi të praktikës gjyqësore, lidhur me të drejtën e mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët për të bërë ose jo ankim kundër vendimit të gjykatës së rrethit të dhënë] në mungesë të të pandehurit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr.386, datë 20.7.1999 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.48, datë 10.3.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe pushimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë me arsyetimin se mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve është person i palegjitimuar për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me këtë vendim kanë vendosur të ndryshojnë praktikën gjyqësore të mëparshme, duke u shprehur, ndër të tjera, si më poshtë:

“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.47, datë 28.01.1999 për të unifikuar praktikën gjyqësore kanë legjitimuar mbrojtësin e caktuar kryesisht të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, por në të njëjtin pozicion procedural konsiderohet edhe mbrojtësi i të pandehurve në mungesë Baki dhe Albert Huqi sepse, pavarësisht se është zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve, ai është lejuar dhe pranuar në gjykim për të zëvendësuar mbrojtësin që gjykata

duhej të caktonte kryesisht për të plotësuar detyrimin ligjor që ajo kishte sipas nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale.

Për arsyet e përmendura më lart çmohet se vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nuk është i drejtë dhe krijon anomali në zhvillimin e procesit penal, prandaj diktohet e nevojshme marrja e një vendimi tjetër nga Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e një praktike gjyqësore tjetër, të ndryshme nga ajo e deritanishmja, në mënyrë që mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve të konsiderohet person i palegjitimuar për bërjen e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurve.”

Kundër vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përmendur më sipër, kanë bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese avokatët e të pandehurve duke parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

“Vendimi bie ndesh me parimet kushtetuese dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal.

Duke qenë përfaqësues ligjor i të pandehurit në mungesë, mbrojtësi gëzon të gjitha të drejtat e një përfaqësuesi, të gjitha të drejtat e mbrojtësit në mbrojtje të detyrueshme ku përfshihet edhe e drejta e ankimit.

Interpretimi i neneve 50/1,407/4 e 410 të Kodit të Procedurës Penale nga Kolegjet e Bashkuara, është i gabuar, sepse sipas këtyre neneve mbrojtësit i njihet e drejta e ankimit.

E drejta e ankimit nuk përfshihet në të drejtat ekskluzive që i rezervohen personalisht të pandehurit.

Ne, si mbrojtësa, jemi pajisur me dy akte përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji, prandaj kemi të drejtën e ankimit sipas nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi i gjykatës është kontradiktor sepse nuk bën dallimin midis të drejtës së ankimit dhe të drejtës për të kërkuar rivendosijen e afatit të humbur për të bërë ankim.

Kolegjet e Bashkuara, kanë prishur vendimin e gjykatës së Apelit, duke pushuar gjykimin në Gjykatën e Lartë, pa u shprehur se ç’duhet bërë me çështjen apo me vendimin e shkallës së parë, kërkesa këto të parashikuara në nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale”

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.17, datë 17.4.2000, që ka hyrë në fuqi më datën 10.5.2000, pas botimit në Fletoren Zyrtare, ka vendosur:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.386, datë 20.7.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Çështja i dërgohet për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi u njohën me përmbajtjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Thimjo Kondi e Nikoleta Kita, pasi dëgjuan prokurorin Arqile Lole i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Apelit Durrës për Baki Huqin dhe prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e rrethit Durrës, avokatët që kërkuan lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Apelit, dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

V Ë R E J N Ë:

Pas marrjes së vendimit për këtë çështje nga Gjykata Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndodhen përpara situatës qj, nga njëra anë, shfuqizohet si antikushtetues vendimi i tyre nr.386, datë 29.7.1999 dhe, nga ana tjetër, çështja i dërgohet për rishqyrtim po Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sepse sipas nenit 132/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, d.m.th. ajo nuk mund t’i japë zgjidhje përfundimtare çështjes konkrete, që është në juridiksionin gjyqësor të zakonshëm.

Duke qenë se Kolegjet e Bashkuara janë të detyruara të rishqyrtojnë çështjen pas shfuqizimit të vendimit të tyre, duke pasur parasysh se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme, duke qenë se, sipas nenit 124/1 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese bën vetëm interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese, si dhe nisur nga fakti që juridiksioni i kësaj

gjykate nuk mund të dalë jashtë kufijve që përcakton neni 131 i Kushtetutës, rrjedhimisht është e domosdoshme që, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese për çështjen në fjalë, të përcaktohen konkretisht çështjet që duhet të zgjidhin Kolegjet e Bashkuara në këtë gjykim të ri.

Gjykata Kushtetuese, duke qenë e ndërgjegjshme që, sipas Kushtetutës, interpretimi i unifikuar i ligjeve është në juridiksionin ekskluziv të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është e mendimit që ato (Kolegjet e Bashkuara) duhet të dalin me një vendim të ri unifikues më pajtim me parimet dhe normat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Fillimisht duhet të nisemi nga pretendimet e avokatëve të parashtruara në kërkesën e tyre, me të cilën është vënë në lëvizje Gjykata Kushtetuese, të evidentojmë problemet me karakter kushtetues, që ata kanë ngritur, dhe mandej të gjejmë zgjidhjet që ka ofruar kjo gjykatë nëpërmjet interpretimit prej saj të normave kushtetuese.

Në kërkesën e tyre avokatët shprehen në përgjithësi se: “Vendimi [i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë] bie ndesh me parimet kushtetuese dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal”. Lidhur me sa pretendojnë, nuk është dhënë asnjë argument për shkelje të së drejtës kushtetuese të mbrojtjes në procesin penal, ndërsa në pjesën tjetër të ankimit avokatët bëjnë referenca në disa dispozita të Kodit të Procedurës Penale, duke pretenduar se vendimi i ankimuar prej tyre është i paligjshëm, kontradiktor, dhe nuk është shprehur se ç’duhet bërë me çështjen dhe me vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në thelb ata pretendojnë se zgjidhjet ligjore që ofron vendimi i Gjykatës së Lartë, sipas tyre, janë të gabuara sepse të tilla janë interpretimet e dispozitave procedurale penale që bëhen me këtë vendim. Pretendimi i tyre i mbështetur vetëm mbi interpretimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, do ta vinte Gjykatën Kushtetuese në pozicionin e gjykatës më të lartë të sistemit gjyqësor në “piramidën” gjyqësore, duke i dhënë asaj juridiksionin për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Lartë, madje edhe të atyre unifikuese të marra prej saj sipas të drejtës ekskluzive që i jep neni 141/2 i Kushtetutës “për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore”.

Duke iu referuar vendimit nr.17, datë 17.4.2000 të Gjykatës Kushtetuese vërejmë se referencat dhe arsyetimet në fushën kushtetuese, (duke mos pasur praktikisht mundësi të veçojmë nga konteksti i frazave pjesët që kanë të bëjnë me konsiderata lidhur me interpretimin e normave ligjore procedurale), janë, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke bërë interpretime të gabuara të dispozitave të Kodit të Procedurës penale, që parashikojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal për gjykimet në mungesë të të pandehurit, kanë cënuar parimet kushtetuese të mbrojtjes si dhe të procesit të rregullt ligjor të garantuara nga nenet 31/ç dhe 42 të Kushtetutës...”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë interpretuar gabim ligjin, duke shkelur një të drejtë themelore të qytetarëve dhe njëkohësisht, kanë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor...

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara, është rrjedhojë e një procesi të parregullt edhe për një shkak tjetër, sepse nga njëra anë pranohet për shqyrtim rekursi i prokurorit kundër vendimit të pafajësisë dhe, nga ana tjetër, duke mos vendosur moslegjetimimin e mbrojtësit të caktuar nga familjarët, i vë palët në pozita të pabarabarta. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim edhe me kërkesat e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën e Gjykatës Europiane, për respektimin e kërkesave për “barazinë e armëve”, që secilës palë t’i sigurohen mundësitë përkatëse për t’i parashtruar çështjet e saj në kushte që nuk e vënë atë në gjendje shumë më pak të favorshme se sa palën e kundërt.

Moslegjitimimi i mbrojtësit për të bërë ankim sipas konceptit të pranuar nga Gjykata e Lartë, do të thellonte më tej pabarazinë e palëve në proces në rastet kur prokurori ushtron rekursin kundër vendimit të pafajësisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë...

Caktimi i mbrojtësit në mënyrat dhe kriteret e parashikuara nga ligji, përfshirë edhe mbrojtësin e caktuar kryesisht dhe njëkohësisht, e drejta e tyre për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, ka për qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor në të gjitha shkallët e gjykimit, siç përcaktohet edhe në nenin 2/2 të Protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 14/5 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike...

Cënimi i procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasqyrohet edhe në një aspekt tjetër në Vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kështu dispozitivi i

vendimit vjen në kundërshtim me nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale...”

Duke nënvizuar më lart pjesët e vendimit të Gjykatës Kushtetuese synojmë të gjejmë në të interpretime të normave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të instrumentave juridike ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe pjesë nga arsyetimet e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (case law). Kolegjet e Bashkuara në rishqyrtimin e çështjes mbi bazën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk gjenë interpretime përfundimtare të normave kushtetuese, por vetëm pohimin se janë shkelur parimet kushtetuese të mbrojtjes në procesin penal e të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Përkundrazi, bëhen përpjekje që argumentet të jepën nëpërmjet analizës e interpretimit të një sërë normave të Kodit të Procedurës Penale, gjë që del jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese e që nuk formon jurisprudencë kushtetuese. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese i lejon vetes edhe nxjerrjen e konkluzioneve të tilla si: vendimi është i pabazuar për shkak të inkonsekuençës së tij; përbën një arsyetim të gabuar e jologjik; është kontradiktor dhe alogjik etj. Këto konsiderata e nxjerrin atë jashtë kufijve të pushteteve që i jep Kushtetuta dhe, për rrjedhojë, janë të papranueshme.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se procesi i gjykimit i kësaj çështjeje është zhvilluar rregullisht, duke u zbatuar drejt dispozitat e ligjit procedural, ashtu siç i kupton dhe interpreton ato Gjykata e Lartë.

Edhe në këtë rishqyrtim të çështjes, të imponuar prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të marrë pa pasur ankuesit legjitimitet për ta vënë çështjen në lëvizje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vazhdojnë t'i qëndrojnë mënyrës së mëparshme të interpretimit të normave procedurale penale, që kanë lidhje me çështjen, duke konkluduar përsëri e përfundimisht, edhe me argumenta të reja e më të plota, se:

Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata ose i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit, për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet në mungesë të të pandehurit për të mbrojtur interesat e tij, nuk është person i ligjitimuar nga normat e ligjit procedural penal në fuqi për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit. Ai legjitimohet vetëm në qoftë se është pajisur me një prokurë të posaçme të lëshuar nga vetë i pandehuri e të vërtetuar rregullisht sipas ligjit.

Për të argumentuar qëndrimin e mësipërm Kolegjet e Bashkuara u referohen dhe analizojnë dispozitat përkatëse kushtetuese që rregullojnë të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit, në procesin penal, të drejtën e ankimit të vendimit në një gjykatë më të lartë, si dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor lidhur ngushtë me to.

Sipas nenit 31 të Kushtetutës, “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

...ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të...”

Formulimi i dispozitës kushtetuese të mësipërme është i njëjtë me formulimin e nenit 6/3, pika “c”, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit: “...Çdo i akuzuar ka të drejtë, ndër të tjera dhe kryesisht:...

c) Të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij...”

Nga ana tjetër nenit 6 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se:

“1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat.

2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhem interesat e tij ligjore” (neni 6 i Kodit të Procedurës Penale).

Njëkohësisht Kodi i Procedurës Penale parashikon edhe gjykimin në mungesë të të pandehurit që nuk paraqitet në gjyq pa pasur pengesa objektive e të pashmangshme për një gjë të tillë, ose kur provohet që ai i fshihet drejtësisë, pasi të jenë respektuar më parë të gjitha procedurat ligjore të njoftimit dhe të komunikimit të akteve. Në rastet e gjykimit në mungesë, në qoftë se i pandehuri madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nuk ka caktuar vetë një mbrojtës, gjykata është e detyruar t'i caktojë kryesisht një avokat për të kryer detyrën e mbrojtësit në gjykim.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se mospërmbyshja e këtij detyrimi për t'i caktuar mbrojtës të pandehurit që gjykohet në mungesë do të përbënte shkeje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit, “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çenohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim, nuk konstatojmë ndonjë papajtueshmëri të dispozitave ligjore të sipërcituara e të analizuara më lart me përmbajtjen e neneve 31, pika “ç”, dhe 42 të Kushtetutës, si dhe me përmbajtjen e nenit 6/3, pika “c”, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu as praktikisht nuk pretendohet ndopnjë shkelje konkrete e të drejtave të të dy të pandehurve, që i fshihen drejtësisë, për të cilët është vendosur të gjykohen në mungesë. Si konkluzion, në gjykimin në shkallë të parë të pandehurve u janë garantuar të drejtat kushtetuese të mbrojtjes dhe të një procesi të rregullt ligjor.

Le të vazhdojmë më tej me të drejtën kushtetuese të të pandehurit për t’u ankuar kundër vendimit gjyqësor të dhënë kundër tij. Sipas nenit 43 të Kushtetutës, “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”. Nënvizojmë që në fillim se rasti në shqyrtim nuk është nga ata për të cilët në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Pra, është e detyrueshme që të pandehurve të mos u mohohet e drejta e apelit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është në harmoni me nenin 2 të Protokollit shtesë nr.7 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit: 1. “Çdo person i deklaruar fajtor nga një gjykatë për një shkelje penale ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një juridiksioni më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, janë të përcaktuara me ligj”.

Duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, konstatojmë se me ligj të pandehurve u njihet dhe u garantohet e drejta e ankimit, e cila është një e drejtë ngushtësisht personale. Sipas nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale, “1. I pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij.

2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji.”

Duke analizuar dispozitat e mësipërme ligjore nuk konstatohet ndonjë kufizim i të drejtës kushtetuese të të pandehurit që gjykohet në mungesë për t’u ankuar kundër vendimit të dhënë ndaj tij, por vetë gjykimi në mungesë i të pandehurit, i parashikuar në Kodin tonë të Procedurës Penale, përbën një kufizim të së drejtës kushtetuese të të pandehurit për t’u mbrojtur. Në këtë rast mund të shtrohet për diskutim problemi në se ky kufizim, i bërë me ligj, është apo jo brenda parametrave të nenit 17 të Kushtetutës. Edhe pse një gjë e tillë nuk është pretenduar në këtë gjykim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i japin kësaj pyetje përgjigjen si më poshtë:

Ndodhemi përpara një kufizimi të drejtë të vendosur me ligj për një interes publik e për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve (nevoja e një luftë efektive kundër kriminalitetit, sidomos kundër krimeve të rënda dhe të organizuara), kufizimi është në përpjestim me gjendjen që e dikton atë (principi i proporcionalitetit), dhe ky kufizim nuk çënon thelbin e të drejtës dhe nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas vlerësimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kufizimi i së drejtës së të pandehurit për t’u mbrojtur vetë ose për ta zgjedhur vetë mbrojtësin e tij, për shkak të gjykimit të tij në mungesë, nuk është antikushtetues. Ky kufizim, që është rrjedhojë e zbatimit të ligjit, nuk i tejkalon caqet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Megjithatë, në qoftë se Gjykata Kushtetuese ka mendin të kundërt, ajo, kur t’i paraqitet rasti, nuk ka pengesë që t’i shpallë antikushtetuese dhe t’i shfuqizojë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë gjykimin në mungesë të të pandehurit. Aktualisht, gjersa këto dispozita janë në fuqi, prezumohet konstitucionaliteti i tyre. Për rrjedhojë, nuk çmohet se ka vend të pezullohet gjykimi dhe t’i kërkohet Gjykatës Kushtetuese të shprehet për pakushtetueshmërinë e dispozitave ligjore të sipërcituara që parashikojnë gjykimin në mungesë të të pandehurit që i fshihet drejtësisë.

Gjithsesi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se kuptimi dhe përmbajtja e nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale janë të qarta e të plota dhe nuk lënë shkak për keqinterpretim. Sidoqoftë, këtu jemi në terrenin e interpretimit të ligjit, i cili është funksion kushtetues ekskluziv i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se sipas nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale të vlerësuar në harmoni me dispozitat e tjera të këtij kodi, e drejta e të pandehurit (edhe e atij që është gjykuar në mungesë) për të bërë ankim kundër vendimit gjyqësor është një e drejtë që i rezervohet personalisht të pandehurit dhe

askujt tjetër (me përjashtim të kujdestarit të të miturit). Kjo e drejtë, e njohur dhe e garantuar në ligj, mund të ushtrohet ose jo, sipas vullnetit të lirë dhe disponimit të vetë të pandehurit. Ligji parashikon gjithashtu se ushtrimi i së drejtës së ankimit mund t'i ngarkohet nga i pandehuri edhe mbrojtësit të tij duke e pajisur këtë të fundit me një akt përfaqësues (prokure) të lëshuar me vullnet të lirë dhe në formën e parashikuar nga ligji.

Në disa raste të praktikës gjyqësore janë lejuar interpretime të gabuara të nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me cilësinë e të përfaqësuarit e të përfaqësuesit me prokurë, si dhe të përmbajtjes e formës së aktit të përfaqësimit. Kur ligjvënësi shprehet për “një akt përfaqësues të lëshuar në format e parashikuara nga ligji”, ai shprehet në përgjithësi, pa bërë ndonjë referencë konkrete në ndonjë ligj të veçantë. Megjithatë, akti i përfaqësimit nuk mund të jetë ndryshe e nuk mund të mos plotësojë elementet bazë të një prokure.

I përfaqësuari, d.m.th. personi në emër e për llogari të të cilit do të bëhet ankimi, nuk mund të jetë person tjetër veç të pëandehurit të gjykuar në mungesë, ndërsa përfaqësues është mbrojtësi i caktuar prej tij. Në rastin kur gjykimi bëhet në mungesë të të pandehurit, sepse ai nuk është paraqitur në gjyq ose i fshihet gjykimit, avokati mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata, ose ai i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit, nuk përfaqëson vullnetin e të pandehurit sepse nuk ka tagër përfaqësues prej tij. Ai kryen vetëm një funksion publik që i është ngarkuar nga gjykata në interes të drejtësisë, për të ndihmuar në mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit në gjyq dhe për të garantuar një minimum standardi të një procesi të rregullt ligjor. Në qoftë se një i pandehur gjykohet në mungesë dhe gjatë një gjykimi të tillë nuk i caktohet një avokat mbrojtës, atëhere procesi nuk mund të quhet i rregullt sepse, edhe një aspektin thjesht formal, nuk mund të sigurohet kontradiktorialiteti dhe një minimum i nevojshëm i “barazisë së armëve” ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, ose, i thënë ndryshe, një balancë e arsyeshme ndërmjet interesit publik të gjykimit të krimit e të ndëshkimit të fajtorit, nga njëra anë, dhe interesit privat të garantimit të të drejtave procedurale të të pandehurit në gjykimin që zhvillohet në mungesë të tij, nga ana tjetër. Misioni si më sipër i mbrojtësit mbaron me përfundimin që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për të pandehurin është një e drejtë ngushtësisht personale e tij dhe, si e tillë, ajo nuk mund të ushtrohet jashtë vullnetit të tij të lirë, të paraqitur në mënyrë të shprehur dhe në një formë të caktuar të domosdoshme për vlefshmërinë dhe provueshmërinë e aktit.

Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata në gjykimin në mungesë, në rastet kur nuk është pajisur me një prokurë të lëshuar nga vetë i pandehuri, për të bërë ankim kundër vendimit, nuk mund të ushtrojë këtë të drejtë për shkak se i mungon tagri për të vepruar në emër e për llogari të të pandehurit.

Ndërsa mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit edhe sikur të ketë prokurë prej tyre, për të bërë ankim kundër vendimit, kjo prokurë është e pavlefshme.

Përsa i përket formës së prokurës me të cilën duhet të jetë i pajisur mbrojtësi për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, gjersa Kodi i Procedurës Penale nuk jep zgjidhje konkrete, atëhere duhet të kemi parasysh kërkesat e dispozitave të ligjeve të tjera që e parashikojnë atë. Është e domosdoshme, që, për efekt të vlefshmërisë së tij, akti i përfaqësimit të jetë në formë shkresore, por, që të sigurojë vërtetësi për përmbajtjen e saj dhe për personin e të përfaqësuarit d.m.th. për efekt provueshmërinë, ajo duhet të jetë në formë noteriale. Pra, forma e kërkuar nga ligji, në kuptim të nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, është forma noteriale ose e vërtetuar, sipas rastit, nga një autoritet tjetër i njohur me ligj.

Në thelb, moslejimi i së drejtës së ankimit të mbrojtësit të caktuar nga gjykata kryesisht ose të caktuar nga të afërmit e të pandehurit, në rastet e gjykimit në mungesë, kur mungon akti i përfaqësimit apo kur ai është i pavlefshëm, nuk i dëmton interesat e tij. Një mbrojtës i tillë, duke mos pasur mundësi të kontaktojë me të pandehurin e të marrë informacion prej tij, e ka shumë të kufizuar mundësinë për të siguruar prova që do ta shfaqësonin të pandehurin ose do të lehtësonin pozitën e tij.

Mosushtrimi i së drejtës kushtetuese të të pandehurit kundër vendimit të gjykatës të dhënë në mungesë të tij, kur ai i fshihet drejtësisë, mund të vijë si rrjedhojë e një vendimi të marrë me vullnetin e tij të lirë e që nuk mund të disponohet nga të tjerët, por mund të jetë edhe për shkak të një pamundësie objektive, për provimin e së cilës barra e provës i takon vetë të pandehurit, gjatë

ushtrimit më vonë të mjeteve të tjera mbrojtëse që i njeh ligji (Kodi i Procedurës Penale).

Mbas gjykimit të çështjes në mungesë vendimi i gjykatës së shkallës së parë i njoftohet të pandehurit konform kërkesave të nenit 140, 141, të Kodit të Procedurës Penale. Lajmërimi i depozitimit të vendimit afishohet në banesën e të pandehurit, qendrën e punës, ju komunikohet fqinjëve ose të afërmeve të tij, ndërsa në rastin e të pandehurit që i fshihet ndjekjes penale ligji parashikon njoftimin e tij nëpërmjet dorëzimit të aktit mbrojtësit të tij dhe, kur nuk ka të tillë, mbrojtësit të caktuar kryesisht.

Mbas respektimit të të gjitha rregullave të mësipërme vendimi konsiderohet ligjërishit i njoftuar dhe për të pandehurin fillon përllogaritja e afatit të ankimit. Plotësimi i afatit ligjor të ankimit i jep vendimit formën e prerë dhe në rastin e mungesës ai ankimohet vetëm kushtet e caktuara ligjore.

I pandehuri në mungesë, si rregull, ndodhet në pozitë më të favorshme në qoftë se vendimi i shkallës së parë merr formë të prerë pa u ankimuar, se sa në qoftë se vendimi do të mund të ankimohej në të gjitha shkallët dhe të lihej në fuqi. Ankimi i vendimit në të gjitha shkallët e gjykimit nga persona të paautorizuar prej vetë të pandehurit do të çonte në një zgjidhje përfundimtare të çështjes dhe në ezaurim të mjeteve mbrojtëse të të pandehurit.

Përkundrazi, i pandehuri që është gjykuar në mungesë, me të marrë dijeni për vendimin e dhënë kundër tij, ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit të tij, duke pasur barrën e provës për të provuar se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

Sipas nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale, “Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin”.

Duke iu referuar e analizuar dispozitën e mësipërme, nuk është e vështirë të konstatohet se, në qoftë se të drejtën e ankimit do ta kishte avokati mbrojtës i të pandehurit në mungesë, i caktuar kryesisht nga gjykata apo të afërmit e tij, atëhere e drejta e ankimit do të ezaurohej dhe nuk do të kishte kuptim të ushtrohej për të dytën herë nga vetë i pandehuri pas rivendosjes në afat. Gjithashtu, në këtë eventualitet, një konflikt interesash do të ishte i pashmangshëm.

Përsa u përket rasteve kur çështjen në Apel e çon prokurori ose të pandehurit e tjerë, që nuk kanë qenë në mungesë apo që janë përfaqësuar rregullisht nga avokatë mbrojtës të caktuar prej tyre, ato do të trajtohen njëllë si rasti kur një i pandehur ka marrë dijeni rregullisht për vendimin e dhënë kundër tij dhe nuk e ka çmuar të leverdisshme për të bërë ankim. Në këto raste ligji i ka zgjidhur drejt kufijtë e shqyrtimit të çështjes në një gjykatë më të lartë dhe efektet e gjykimit për palët në proces.

Duhet të nënvizojmë se në këto raste gjykata është e detyruar që gjatë shqyrtimit të çështjes t’i caktojë përsëri një avokat mbrojtës të pandehurit që vazhdon të gjykohet në mungesë. Kjo do të garantojë një minimum të domosdoshëm të mbrojtjes së të drejtave procedurale të të pandehurit në mungesë dhe një proces të rregullt ligjor.

Gjithashtu, i dënuari në mungesë objektivisht i ka mundësitë më të mëdha që të kërkojë rishikimin e vendimit të dhënë kundër tij (nenet 449-450 të Kodit të Procedurës Penale), sepse ai nuk i ka konsumuar provat që mund të ketë, me të cilat ka të drejtë të provojë pafajësinë e tij ose të provojë rrethana që ia lehtësojnë pozitën.

Së fundi, edhe arsyetimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese, sipas të cilit neni 441 i Kodit të Procedurës Penale nuk e parashikon pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dhe se, në këtë mënyrë, është lënë pa zgjidhur çështja konkrete mbi fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve, dhe nuk qëndron.

Së pari, kjo është një çështje interpretimi ligji dhe, si e tillë, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Së dyti, asnjë gjykatë nuk mund të tërhiqet nga zgjidhja e një çështjeje edhe në qoftë se konstaton që ka boshllëk në ligj.

Duke u vendosur prishja e vendimit nr.48, datë 10.3.1999 të gjykatës së Apelit Durrës, mbetet në fuqi vendimi nr.205, datë 30.10.1998 i gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës, të cilin gjykata e Apelit Durrës padrejtësisht e ka shqyrtuar sepse ankimi është bërë nga persona të palegjitimuar.

Si konkluzion, çështja nuk ka mbetur pa u zgjidhur, siç shprehet Gjykata Kushtetuese. Ajo është zgjidhur përfundimisht nga gjykata e shkallës së parë dhe vendimi konsiderohet se ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Është e drejtë e të dënuarve të gjykuar në mungesë që, me t'u vënë në dijeni për vendimin e dhënë kundër tyre, të kërkojnë, apo të mos kërkojnë, rivendosjen në afat të ankimit të tyre, apo të kërkojnë ose jo rishikimin e vendimit. Duke qenë se ata janë madhorë, këto të drejta të tyre nuk mund të ushtrohen nga askush tjetër, pa pasur një akt përfaqësimi të lëshuar prej tyre.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pas rishqyrtimit të kësaj çështjeje për unifikim të praktikës gjyqësore në zbatim të detyrimit kushtetues që rrjedh nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, duke zgjeruar bazën e arsytimit e duke shtuar argumente të reja më të plota, në analizë të fundit arrijnë në të njëjtat përfundime që kanë arritur më parë për këtë çështje. Për këtë arsye e çmojnë të nevojshme e të dobishme që, nëpërmjet këtij vendimi, të dalin edhe me disa konsiderata më të përgjithshme përsa i përket të drejtës kushtetuese të Kolegjeve të Bashkuara të parashikuar në nenin 141/2 të Kushtetutës. Kjo bëhet në funksion të një kuptimi më të drejtë e më të saktë të ndarjes së juridiksionit midis Gjykatës Kushtetuese e Gjykatës së Lartë, si dhe për të kontribuar në mënyrë konstruktive e të argumentuar në arritjen e zgjidhjeve të drejta e të pranueshme nga të dyja palët në të ardhmen.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, interpretimi i ligjeve është funksion që ligjvënësi i jep gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa interpretimet me karakter unifikues, të cilat përbëjnë një jurisprudencë të detyrueshme për t'u ndjekur nga gjykatat e të gjitha shkallëve në çështje të tjera të ngjashme, janë funksion ekskluziv i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjykatës së Lartë, nëpërmjet interpretimit të dispozitave të ligjit material e procedural relevante me çështjen në shqyrtim, i takon “fjala e fundit” për t'u shprehur lidhur me atë se cili është kuptimi e përmbajtja e saktë e këtyre dispozitave, sipas vullnetit të ligjvënësit dhe situatave specifike që rezultojnë në një kontekst të caktuar social-ekonomik, historik e aktual, duke u konformuar dhe përshtatur kurdoherë me normat e parimet kushtetuese e me parimet themelore të së drejtës.

Pra, është e detyrueshme që, në analizë të fundit, ligji të kuptohet, të interpretohet dhe të zbatohet ashtu siç thotë Gjykata e Lartë në Kolegjet e saj të Bashkuara. Askush tjetër nuk mund ta zëvendësojë Gjykatën e Lartë, as nuk mund të dalë mbi të e t'i imponohet, në këtë funksion ekskluziv kushtetues. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të qartë e të shprehur nuk i jep Gjykatës Kushtetuese funksionin dhe pushtetin për të bërë interpretimin e ligjeve, por vetëm atë për të vendosur në se një ligj apo normë e kontestuar është apo jo në pajtim me normat e parimet e kushtetutës, duke e analizuar këtë nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normave kushtetuese. Shprehja “interpretim përfundimtar i Kushtetutës”, nënkupton që interpretimin e normave të Kushtetutës, brenda kuadrit të funksionit e të juridiksionit të vet, të përcaktuar në Kushtetutë, ka të drejtë dhe detyrim ta bëjë çdo organ kushtetues i secilit pushtet. Në këtë kuptim kjo prerogativë u përket edhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë të drejtë të zbatojnë edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat kushtetuese. Sipas nenit 4/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe”. Kjo do të thotë se organet e tjera kushtetuese, veç Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të ofrojnë një interpretim e zbatim të drejtpërdrejtë të një norme kushtetuese, në qoftë se vetë kjo kërkon, për të gjetur zbatim, miratimin pas saj të një ligji, apo të akteve e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që, kur kanë locus standi lidhur me çështjen që u është paraqitur për shqyrtim, të bëjnë interpretimin e normave të akteve të legjislativit e të ekzekutivit duke u nisur nga parimi i prezumimit të konstitucionalitetit të ligjeve. Në këtë kontekst, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shpjegojnë e argumentojnë pse dispozita ligjore, apo akti ekzekutiv, duhet interpretuar e zbatuar në këtë apo atë mënyrë, për të qenë e pajtueshme me kuptimin dhe përmbajtjen e dispozitës përkatëse kushtetuese, në bazë e për zbatim të së cilës ajo ka dalë. Kur gjykata e juridiksionit të zakonshëm jep argumenta të pajtueshmërisë së një ligji me dispozitat kushtetuese, në bazë e për zbatim të së cilës ajo ka dalë. Kur gjykata e juridiksionit të zakonshëm jep argumenta të pajtueshmërisë së një ligji me dispozitat kushtetuese dhe arrin në një përfundim pozitiv lidhur me të, ajo në mënyrë të pashmangshme, krahas interpretimit të ligjit bën edhe interpretimin e normës

kushtetuese ku mbështetet ky ligj. Është e qartë që ky interpretim kushtetues nuk është përfundimtar dhe ka vetëm efekt inter partes. Ky interpretim kushtetues i një gjykate të juridiksionit të zakonshëm, i cili merr karakter detyrues për të gjitha gjykatat në qoftë se realizohet apo konfirmohet me një vendim të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mund të rrëzohet nga Gjykata Kushtetuese, në rastet kur ajo më pas del një vendim të kundërt për një çështje në juridiksionin e saj të përcaktuar në nenin 131, pika “a”, “b”, “c”, të Kushtetutës. Në të kundërt, në qoftë se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion dhe locus standi për një çështje të caktuar, ajo nuk mund të shfuqizojë një ligj apo normë ligjore. Përsa i përket një vendimi gjyqësor, aq më tepër një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, ajo jo vetëm nuk mund të prezantojë një interpretim tjetër ligjor, të ndryshëm nga interpretimi që kanë bërë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, e t’i japë karakter detyrues këtij interpretimi, siç bën në çështjen në shqyrtim me vendimin e saj nr.17, datë 17.4.2000. Ajo gjithashtu, siç e argumentojmë më lart, nuk mund të rrëzojë interpretimin kushtetues pozitiv të bërë nga Gjykata e Lartë, duke vepruar tej kufijve të juridiksionit dhe të legjitimitetit të subjekteve përkatës që kanë të drejtë ta venë atë në lëvizje.

Në rastet e juridiksionit të saj sipas pikës “f” të nenit 131 të Kushtetutës, kur ajo ka juridiksion për të vendosur për “gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”, Gjykata Kushtetuese, të cilës i është paraqitur ankesa për të goditur një vendim të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se është shkelur standardi kushtetues “për një proces të rregullt ligjor”, ka të drejtë dhe është e detyruar që në kuadër të shqyrtimit të çështjes konkrete të përcaktojë vetëm se cilat janë parametrat kushtetuese “të procesit të rregullt ligjor” dhe cilat janë konkretisht këto shkelje, që sjellin pakushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor të atakuar. Gjithsesi, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë për shkelje të parametrave kushtetuese duke u mbështetur në një interpretim që ajo u bën vetë normave të një ligji të zakonshëm, të ndryshëm nga interpretimi që u kanë bërë këtyre normave gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e, në veçanti, të ndryshëm nga interpretimi që është bërë me një vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Është e diskutueshme nëse Gjykata Kushtetuese, në një gjykim të iniciuar në bazë të nenit 131, pika “f”, të Kushtetutës, në mënyrë incidentale, mbi bazën e kërkesës së një individi, në gjykimin e filluar, të shprehet për pajtueshmërinë ose jo të ligjit (apo të normës së veçantë të tij) me Kushtetutën. Në qoftë se Gjykata Kushtetuese do të konkludojë që e ka këtë të drejtë, ajo mund të shprehet për pakushtetutshmërinë e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, vetëm pasi të jetë shprehur më parë për pakushtetutshmërinë e dispozitave ligjore që lidhen me çështjen e, në këtë kuadër, edhe për pakushtetutshmërinë e interpretimit të unifikuar që u është bërë këtyre normave nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, duke u shfuqizuar si antikushtetuese norma e ligjit, bashkë me të bie edhe interpretimi që i ka bërë asaj norme Gjykata e Lartë. Si përfundim, në këtë lloj gjykimi, i cili iniciohet sipas një procedure të caktuar, Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të bëjë interpretim të ligjit, sikundër ka vepruar në rastin konkret, por ka të drejtë vetëm të bëjë interpretim të dispozitave përkatëse kushtetuese, të cilave, sipas vlerësimit të saj, u bie ndesh dispozita e ligjit të zakonshëm, që ka atë kuptim e përmbajtje që i ka dhënë asaj Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të nenit 441, pika “c” të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit nr.48, datë 10.3.1999 të gjykatës së Apelit Durrës dhe pushimin e gjykimin të çështjes në shkallë të dytë.
2. Ky vendim unifikues për praktikën gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Gjykimi në mungesë është një institut që gjen rregullimin si në Kushtetutë, ashtu edhe në Kodin e Procedurës Penale.

Në nenin 33 të Kushtetutës sanksionohet: “Kushdo ka të drejtë të dëgjohej para se të gjykohej. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë”.

Nga dispozita kushtetuese e sipërcituar, pjesëmarrja dhe prezenca e të pandehurit në gjykim, nuk është detyrim, por e drejtë e të pandehurit. Për rrjedhojë, vetëm kur vërtetohet se i pandehuri i fshihet drejtësisë ose nuk dëshiron të realizojë të drejtën e paraqitjes para gjykatës, atëherë gjykimi i tij mund të bëhet në mungesë.

Gjykimi në mungesë bëhet duke respektuar të drejtën e të pandehurit për mbrojtje. Në rastet e gjykimit në mungesë, në qoftë se i pandehuri i rritur nuk ka caktuar vetë një mbrojtës, gjykata është e detyruar t'i caktojë vetë kryesisht një avokat për të kryer detyrën e mbrojtësit në gjykim (neni 49 i Kodit të Procedurës Penale). Realizimi i mbrojtjes në gjykimin në mungesë është përcaktuar hollësisht në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Kodi i Procedurës Penale me anë të dispozitave të tij, ka krijuar të gjitha garnacitë e nevojshme kushtetuese që gjykimi në mungesë të mos zhvillohet kur i pandehuri dëshiron të jetë i pranishëm, por për shkaqe objektive ose për mungesë njoftimi, nuk është paraqitur në gjykim.

Këto rregulla janë të përcaktuara në nenet 350, 351, 352 dhe 427 të Kodit të Procedurës Penale. Dispozitat e cituara më sipër rregullojnë gjykimin në mungesë si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e apelit.

Për gjykimin në shkallë të parë ligji parashikon: “Kur i pandehuri i lirë ose i paraburgosur nuk paraqitet në seancë ndonëse është njoftuar dhe nuk ka patur shkaqe të ligjshme për t'u paraqitur, gjykata, pasi dëgjon palët, deklaron mungesën e tij. Në këtë rast, ai përfaqësohet nga mbrojtësi”.

Vendimi që deklaron mungesën është i pavlefshëm kur provohet se ajo ka ardhur nga mosmarrja e njoftimit ose nga pamundësia absolute për t'u paraqitur.

Në qoftë se i pandehuri paraqitet pas shpalljes së vendimit, gjykata revokon vendimin që ka deklaruar mungesën. Kur paraqitja bëhet para fillimit të diskutimit përfundimtar, i pandehuri mund të kërkojë të pyetet. Mbeten të vlefshme verpimet e kryera më parë, por kur i pandehuri provon se njoftimi është bërë me vonesë jo për fajin e tij, gjykata urdhëron marrjen ose përsëritjen e veprimeve që çmon se kanë rëndësi për marrjen e vendimit” (neni 351 i Kodit të Procedurës Penale).

Kur këto rregulla nuk janë zbatuar, gjykata e apelit sipas pikës “4” të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë të vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore.

Në praktikë ka lindur si problem se si duhet të trajtohet mbrojtësi i caktuar kryesisht për gjykimet në mungesë, a ka ai të njëjtat të drejta që ligji i njej të pandehurit, a mund ai të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr.386 datë 29.7.1999 kanë vendosur se mbrojtësi i caktuar është një person i palegjitimuar për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit.

Kundër këtij vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara kanë bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese avokatët e të pandehurve Baki Huqi e Albert Huqi.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.17 datë 17.4.2000 ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.386 datë 29.7.1999 të Kolegjeve të Bashkuara dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kolegjet e Bashkuara pasi e rigjykan çështjen vendosën përsëri se mbrojtësi i caktuar nuk legjitimohet për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë.

Me këtë zgjidhje të Kolegjeve të Bashkuara nuk jam dakord për arsyet që po parashtrij më poshtë:

Problemi kryesor që diskutohet në çështjen objekt gjykimi është nëse avokati i caktuar kryesisht mundet të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit. Ky moment proceduralisht është rregulluar nga neni 410 i Kodit të Procedurës Penale ku thuhet: “Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshur në format e parashikuara nga ligji”.

Zgjidhja e dhënë nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë janë të ndryshme. Gjykata e Lartë arsyeton se mbrojtësi i caktuar është një person i palegjitimuar për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit. Gjykata Kushtetuese arsyeton të kundërtën. Në vendimet e saj Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet: “Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke bërë interpretime të gabuara të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë të drejtat e mbrojtësit në procesin penal për gjykimet në mungesë të të pandehurit, kanë cënuar parimet kushtetuese të mbrojtjes si dhe të procesit të rregullt ligjor të garantuar nga nenet 31/ç dhe 42 të Kushtetutës”.

Të dyja gjykatat arsyetimet e tyre i mbështesin në të drejtën ekskluzive që u jep Kushtetuta. Gjykata e Lartë citon nenin 141/2 të Kushtetutës që i jep të drejtë asaj “për njesimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore”. Gjykata Kushtetuese citon nenet 31/ç, 42, 124/1 dhe 131/f të Kushtetutës.

Interpretimi me karakter unifikues, është funksion kushtetues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Askush tjetër nuk mund ta zëvendësojë Gjykatën e Lartë në këtë funksion ekskluziv kushtetues. Por duhet theksuar se interpretimi që bën Gjykata e Lartë nuk është interpretim përfundimtar. Ky interpretim nuk ka fuqi detyruese të përgjithshme siç parashikon neni 132/1 i Kushtetutës. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka karakter detyrues vetëm për gjykatat më të ulta. Ky konkluzion del nga neni 141/2 i Kushtetutës ku thuhet se: “Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore, për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

Çdo organ kushtetues, cilido qoftë ai, pushteti ligjvënës, ekzekutiv ose gjyqësor, dispozitat e Kushtetutës i zbaton drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe (neni 4/3 i Kushtetutës). Dispozita Kushtetuese e përmendur më sipër u jep të drejtë këtyre organeve, të bëjnë interpretimin e normave kushtetuese sipas fushave të veprimtarisë së tyre. Por në qoftë se ky interpretim i bërë, nga organet kushtetuese, ankimohet nga subjektet e parashikuara nga neni 134 i Kushtetutës, është e drejtë e Gjykatës Kushtetuese që të bëjë gjykimin përfundimtar. Neni 131/f i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në mënyrë të qartë e të shprehur i jep Gjykatës Kushtetuese funksionin dhe pushtetin për të bërë: “gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.” Gjatë këtij “gjykimi përfundimtar”, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të vendosë nëse interpretimi i bërë nga organet e tjera është ose jo në përputhje me Kushtetutën.

Funksioni dhe pushteti i Gjykatës Kushtetuese nuk buron vetëm nga dispozitat kushtetuese të analizuara më sipër por edhe nga neni 124/1. Në bazë të kësaj dispozite, Gjykata Kushtetuese është ngarkuar me detyrën për të garantuar respektimin e Kushtetutës. Këtë detyrim kushtetues ajo e realizon kur bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Në këtë rast vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 132/1 ka fuqi detyruese të përgjithshme (erga omnes). Në këtë kuadër vendimi i Gjykatës Kushtetuese është detyrues edhe për Gjykatën e Lartë.

ANËTAR
Y.Myrtja

Tiranë, 27.10.2000
Nr.345 i Regj.Themeltar
Nr.371 i Vendimit

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 5.12.2000
Doli nga shtypi më 7.12.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Tipografia Ushtarake”

Çmimi: 150 lekë